



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1420/2 Prot.

Tiranë, më 24 / 10 / 2018

V E N D I M

Nr. 221 , Datë 24 / 10 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, mori në shqyrtim ankesën me nr.164, datë 16.10.2018, të znj.R. I, kundër avokates E. Ç, me objekt pretendimin për diskriminim “*për shkak të gjinisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, gjendjes familjare*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, znj.R. I ka parashtruar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, problematikën e saj. Duke filluar që nga viti 2007, pas divorcit të saj, ka patur probleme familjare dhe konflikte me ish-burrin dhe ish-vjehrrën, lidhur me ndarjen e pasurisë. Këto pretendime ankuesja shprehet se i ka ndjekur gjyqësisht dhe se me anë të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër ajo dhe fëmijët e saj kanë fituar të drejtën e qëndrimit në shtëpi, gjë që ka acaruar më tepër marrëdhëniet me ish-bashkëshortin dhe nënën e tij. Për zgjidhjen e këtij konflikti, për të cilin ishte shprehur gjykata tashmë, ankuesja shprehet se ish-vjehrra e saj i është drejtuar emisionit “Shihemi në gjyq” në Tv Klan, i cili drejtohej nga avokatja E. Ç. Znj.R. I shprehet se me datë 16.03.2016 është telefonuar nga znj.E. Ç, e cila i ka komunikuar se të nesërmen do të

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

regjistrohej seanca pranë ambjenteve të Tv Klan dhe meqenëse do të flitej për të dhe fëmijët e saj, do të ishte mirë që dhe ajo të ishte e pranishme. Me datë 17.03.2016 rreth orës 11-12 është regjistruar emisioni, i cili është bërë publik me datë 10.04.2016. Ankuesja shprehet se gjatë regjistrimit të seancës ka qëndruar tek pjesa e pultit të regjistrimit dhe nuk ka dashur të jetë pjesë e kësaj seance. Mirëpo, ajo citon se duke u ndodhur përpara faktit që situata e paraqitur nga znj.E. Ç nuk ishte në fakt pasqyrim i fakteve të vërteta dhe kishte deformim të qëllimshëm të tyre, ka kërkuar të ndërhyjë me zë, duke menduar se kështu do të arrinte të tregonte të vërtetën dhe të rivendoste në vend dinjitetin e saj. Edhe pas regjistrimit të seancës ajo shprehet se ka kontaktuar me znj.E. Ç për t'i dhënë asaj mundësinë për të vërtetuar të kundërtën e atyre që u thanë gjatë regjistrimit të seancës dhe i ka paraqitur provat dhe pamjet filmike që dispononte, të cilat nuk janë marrë në konsideratë prej saj.

Me datë 08.04.2016 ankuesja citon se i është drejtuar Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit, Komisionit të Licensimit të Ndërmjetësve, Ministrisë të Drejtësisë dhe Tv.Klanit lidhur me kërkesën e saj për të mos e shfaqur seancën e regjistruar me datë 17.03.2016 nga Tv Klan. Pavarësisht kërkesës së saj seanca është transmetuar në Tv Klan me datë 10.04.2016. Pas transmetimit të emisionit, znj.R. I shprehet se komentet e teleshikuesve ishin tepër fyese, të ashpra dhe diskriminuese për të si nënë dhe si femër dhe se ajo pësoi traumë dhe shok psikologjik, gjë për të cilën ka marrë dhe trajtim mjekësor.

Në seancën e publikuar me datë 10.04.2016 në Tv Klan, znj.E. Ç ka patur rolin e ndërmjetëses mes ankueses dhe ish-vjehrrës së saj, dhe me datë 03.10.2018 znj.E. Ç përfaqësoonte ish-vjehrrën e ankueses në seancën gjyqësore në Gjykatën e Apelit Gjirokastrër.

Ankuesja shprehet se ligjërisht znj.E. Ç nuk mund të përfaqësojë si avokate dhe të kryejë ndërmjetësim njëkohësisht për palën e përfaqësuar prej saj (ish-vjehrrën e znj.R. I) me të cilën ankuesja është në një konflikt gjyqësor me objekt padie “Mashttrim në bashkëpunim me pasoja të rënda”.

Znj.R. I në seancën gjyqësore të datës 03.10.2018 ka dorëzuar pranë trupit gjykues kërkesën për përjashtimin e tyre nga gjykimi i kësaj çështjeje. Ajo shprehet se menjëherë pas kësaj, znj.E. Ç i është drejtuar me tone të ashpra, duke e kërcënuar dhe diskriminuar atë: *“Kur flas unë ti mos fol. Në radhë të parë ti duhesh kontrolluar kur futesh këtu sepse ti mban çimka. Të njoh shumë mirë unë ty, por unë nuk jam as M..., as G... (duke iu referuar ish-Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrër, z.G. B, të cilin unë e kam denoncuar publikisht në emisionin investigativ STOP në datën 27.10.2016, për afëra seksuale) Unë nuk jam nga ata persona që ti regjistron, e di unë pse i bën të gjitha këto por mua pas do më kesh, etj...”* Ankuesja shprehet se në ato momente është ndjerë e frikësuar jo vetëm nga toni i zërit por dhe nga gjestet e saj. Pas kësaj situatë, znj.R. I ka telefonuar Komisaratin e Policisë së Gjirokastrës dhe ka depozituar kallëzimin penal me nr.908 për znj. E. Ç lidhur me sa më sipër.

Pas verifikimit të provave dhe fakteve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrër, ka dalë me vendim për mosfillimin e procedimit penal nr.908 të vitit 2018, ndaj znj.E. Ç.

Në përfundim të ankesës së saj ankuesja kërkon konstatimin e diskriminimit, heqjen nga kanali You Tube të seancës publike “Shihemi në gjyq”, të Televizionit Klan dhe falje publike në adresë të personit të saj.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

- Sa i takon kërkesës së ankueses për heqjen nga kanali You Tube të seancës publike “Shihemi në gjyq”, të Televizionit Klan dhe falje publike në adresë të personit të saj, Komisioneri konstaton *subjekti ankues ka marrë dijeni për këtë fakt, (për të cilin dhe pretendon diskriminimin), që më datë 10.04.2016,³ ndërkohë që ankesën e ka paraqitur*

³ Gjë që e ka deklaruar edhe në formularin e ankesës të plotësuar pranë KMD-së (lidhur me datën e publikimit të seancës).

pranë Zyrës së Komisionerit më datë 16.10.2018⁴, pra më vonë se një vit nga marrja dijani, konkretisht më shumë se 2 (dy) vite.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt”, ankesa e znj.R. I, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: ...“*Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës...*”.

Nga ana tjetër, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: ...“*Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34⁵ të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijani për këtë sjellje*”.

Duke qenë se ankuesja është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj⁶, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e saj për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që mund t’i drejtohet gjykatës kompetente.

Sa i takon pretendimit të ankueses për diskriminim të saj nga ana e znj.E. Ç, lidhur me faktin që është ndjerë e kërcënuar dhe e fyer prej saj gjatë seancës gjyqësore të datës 03.10.2018 në ambjentet e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Komisioneri vëren se një pretendim i tillë nuk bazohet në fakte që provojnë elementët diskriminues; është i papajtueshëm me dispozitat e LMD-së dhe për këtë arsye nuk mund të merret në shqyrtim prej tij.

Referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet.

⁴ Data e regjistrimit të ankesës pranë KMD-së.

⁵ Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëshmipërbllim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale.

⁶ Neni 36 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Procedura para gjykatës”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/b, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së znj.R. I, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijoni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Shërbime

Shkaku: Gjini, Gjendje familjare, Përgjegjësi prindërore